

VENDIM
Nr.849, datë 19.12.2003

PËR FUNKSIONIMIN E FOTOTEKËS KOMBËTARE “MARUBI” DHE PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA BASHKIA E SHKODRËS MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1. 2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 3 të nenit 53 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fototeka Kombëtare “Marubi” është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 2. Godina e Fototekës Kombëtare “Marubi” dhe inventari i mjeteve kryesore t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi nga Bashkia e Shkodrës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 3. Fondi për shpenzimet e pagave për punonjësit e Fototekës, të cilët do të përfshihen brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe shpenzimet e tjera të përballohen nga buxheti i vitit 2004 i kësaj ministrie.
 4. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë statutin e Fototekës Kombëtare “Marubi”.
 5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shkrin efektet nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano